



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosova**  
*Qeveria -Vlada-Government*

*Ministria e Shëndetësisë/Ministarstvo Zdravstva/Ministry of Health*  
**Qendra Kombëtare e Kosovës për Transfuzionin e Gjakut**

**Nacionalni Centar za Transfuziju Krvi Kosova- National Blood Transfusion Center of Kosova**

---

## **PARIMET E QKKTGJ-SË PËR PËRZGJEDHJEN E DHURUESVE VULLNETAR TË GJAKUT**

Qendra Kombëtare e Kosovës për Transfuzionit të Gjakut (QKKTGJ) është institucion shëndetësor publik terciar ku organizohen, ofrohen dhe zbatohen shërbimet e transfuzionit të gjakut si dhe aktiviteti arsimor dhe kërkimoro-shkencor. Funksonimi i saj është i rregulluar sipas Ligjit Nr. 06/L-042<sup>1</sup> përmes së cilit rregullohen aktivitetet për dhurimin, testimin, përpunimin, ruajtjen, transfuzionin e gjakut si dhe kontrollin e kualitetit të gjakut dhe komponentëve të tij.

Në realizimin e misionit të tij QKKTGJ-ja është maksimalisht e angazhuar në ruajtjen e shëndetit të dhuruesve të gjakut dhe pacientëve-pranues të gjakut. Ky është obligim ligjor, etik dhe profesional i yni. Rrjedhimisht, QKKTGJ-ja angazhohet që të mos cenohet shëndeti i dhuruesve të gjakut si pasojë e dhurimit të tyre të gjakut, e poashtu angazhohet që gjaku apo produktet e tija të jenë maksimalisht të sigurta për pacientin-pranues të gjakut. Për t'i realizuar këto objektiva vitale, QKKTGJ-ja implementon kritere të selektimit të dhuruesve potencial, të cilat kanë për qëllim selektimin e dhuruesve potencial me shkallë sa më të ulët të rrezikut si për shëndetin e tyre, ashtu edhe për shëndetin e pacientëve të cilët do marrin gjakun e tyre.

Sipas ligjit "Dhuruesi i gjakut" është personi me shëndet të mirë, me anamnezë të mirë medicinale, i përshtatshëm për nga kriteret profesionale mjekësore dhe i cili vullnetarisht jep gjak, plazmë apo qeliza gjaku, për përdorim terapeutik. Në bazë të këtij definicioni, QKKTGJ-ja angazhohet në përzgjedhjen e popullatës sa më të shëndoshë nga dhuruesit potencial të gjakut.

Në procesin e selektimit të dhuruesve potencial QKKTGJ-ja aplikon një numër kriteresh në bazë të të cilave specialistët e Mjekësisë Transfuzive aprovojnë apo refuzojnë dhurimin e secilit dhurues potencial. Dhuruesit potencial paraprakisht miratimit të dhurimit të tyre, fillimisht plotësojnë pyetësorin, japin të dhënat gjenerale, pastaj mjeku specialist ua merr anamnezën dhe bën ekzaminimin fizik të tyre. Rrjedhimisht, dhuruesit potencial duhet t'i përmbushin procedurat e secilës fazë, për t'u aprovuar përfundimisht dhurimi eventual. Duke marrë parasysh se dhurimi është në baza vullnetare, dhuruesi potencial në cilëndo fazë të procesit mund të tërhiqet nga dhurimi i gjakut të. Me qëllim të ruajtjes së privatësisë dhe intimitetit të dhuruesve potencial, në pyetësor janë specifikuar gjendjet, aktivitetet dhe kriteret tjera të cilat i përjashtojnë ata përkohësisht apo në mënyrë permanente nga dhurimi i gjakut,

---

<sup>1</sup> Ligji për gjak dhe përbërës të gjakut. Ligji është miratuar në Kuvendin e Kosovës me 23 Korrik 2018, kurse është shpallur në Gazetën Zyrtare, me datë 20 Gusht 2018.

qoftë për shkak se rrezikojnë shëndetin e tyre (p.sh. sëmundjet kardiovaskulare, sëmundjet kronike sistemike hematologjike, renale etj), apo për shkak se gjaku i tyre potencialisht mund të jetë i dëmshëm për pacientin-pranues i gjakut (p.sh. personat me HIV/AIDS, Hepatit B apo C, personat të cilët kanë përdorur së fundi barëra specifike të cilat mund të jenë prezente ende në gjakun e tyre). Në këtë mënyrë dhuruesit potencial, në fazën e parë të mbushjes së pyetësorit, mund të tërhiqen nga dhurimi nëse e gjejnë veten në ndonjërin prej kategorive refuzuese, pa pasur nevojë të japin informata mbi arsyen e tërheqjes. Qëllimi i këtyre kritereve është maksimizimi i sigurisë së gjakut dhe produkteve tija, dhe këto standarde nuk kanë për qëllim të i dërgojnë porosi cilitdo individ mbi statusin e sëmundjes infektive të tij/saj.

Njëra prej sfidave kyçe në ruajtjen e cilësisë dhe sigurisë së gjakut është parandalimi i transmissioinit të agjensëve infektiv (virusë, bakterie, parazit) nga dhuruesi tek marrësi. Në këtë kategori numërohen posaçërisht agjentët infektiv-shkaktarë të sëmundjeve të rënda si AIDS, Hepatiti B dhe C, Sifilisi, Sëmundja Creutzfeldt-Jacobs, Kala-Azar, Malaria, etj. Disa prej këtyre infeksioneve/sëmundjeve kanë karakter global (HIV/AIDS, Hepatiti B dhe C, Sifilisi), dhe transmetohen me rrugë seksuale andaj edhe në shumicën e vendeve të zhvilluara gjaku iu nënshtrohet testeve laboratorike për këto infeksione/sëmundje.

Gjaku i dhuruar në QKKTGJ i nënshtrohet analizave laboratorike për agjent infektiv të cilët mund të transmetohen përmes gjakut nga dhuruesi tek pacienti. Këto teste aplikohen para se gjaku apo produktet e tija vihen në dispozicion për pacientët. Megjithatë, gjer më sot nuk ekzistojnë teste laboratorike me besueshmëri 100% që do të detektojnë agjentët infektiv të sëmundjeve të rënda të cilat mund të transmetohen me anë të gjakut. Për secilin agjent infektiv, ekziston një “dritare” apo periudhë nga momenti i ekspozimit deri në momentin kur testet laboratorike janë në gjendje të detektojnë prezencën e infeksionit në gjakun e individit. Duke marrë parasysh se këta agjent infektiv transmetohen me rrugë seksuale, gjatë periudhës “dritare”, pyetjet për ekspozim potencial ndaj agjentëve infektiv të cilat iu bëhen dhuruesve, shërbejnë si e vetmja masë mbrojtëse për sigurinë e gjakut. Kjo edhe është arsyeja pse secili shërbim i transfuzionit kudo në botë, iu shtrojnë pyetje dhuruesve potencial mbi aktivitetet seksuale të cilat janë të lidhura me rrezik të lartë të ekspozimit ndaj agjentëve infektiv. Në këtë drejtim QKKTGJ aplikon një skening-pyetësor të gjerë për dhuruesit potencial me qëllim të përzgjedhjes së popullatës me shkallën më të ulët të rrezikut për prezencë të agjentëve infektiv në gjakun e tyre. Pyetjet në pyetësor janë formuluar duke marrë për bazë situatën epidemiologjike në vendin tonë, si dhe direktivat dhe rregulloret e Këshillit Evropian<sup>2</sup> të cilat përcaktojnë kriteret e refuzimit të dhuruesve potencial.

**Sipas Direktivës së Këshillit Evropian 2004/33<sup>3</sup> “personat, sjellja (praktika) seksuale e të cilëve i vendos ata në rrezik të lartë të fitimit së sëmundjeve të rënda infektive të cilat mund të transmetohen përmes gjakut” duhet të refuzohen nga dhurimi i gjakut në mënyrë permanente.**

---

<sup>2</sup> Guide to the Preparation, Use and Quality Assurance of Blood Components, 16 edition (2010) by European Directorate for the Quality of Medicines & HealthCare

<sup>3</sup> Commission Directive 2004/33/EC, fq 8, pika 2.1

Rrjedhimisht, QKKTGJ-ja sikurse pjesa më e madhe e Qendrave të Transfuzionit në vendet e zhvilluara të botës, refuzon grupet vijuese të cilat paraqesin disa nga kategoritë e shumta të cilët në mënyrë permanente refuzohen nga dhurimi vullnetar i gjakut<sup>4</sup>:

1. Personat të cilët ushtrojnë/kanë ushtruar veprimtari të prostitucionit,
2. Personat të cilët kanë paguar para apo kundërvlerë për marrëdhënie seksuale,
3. Meshkujt të cilët kanë pasur kontakt seksual me meshkuj tjerë(MSM).

Secila prej këtyre kategorive paraqesin popullacion me shkallë të lartë të rrezikut për prezencë të agjentëve infektiv në gjakun e tyre, shkencërisht dhe statistikisht të dokumentuar nga komuniteti mjekësor.

MSM ose “meshkujt të cilët kanë pasur kontakt seksual me meshkuj” i referohet cilitdo mashkull i cili ka apo ka pasur seks oral apo anal me një mashkull tjetër. Ky term nuk iu referohet vetëm meshkujve homoseksualëve apo biseksualë, por gjithashtu edhe meshkujve heteroseksual të cilët kanë pasur kontakt seksual me mashkull/meshkuj.

Kriteret e selektimit të dhuruesve të gjakut nuk aplikohen ndaj MSM-ve në bazë të orientimit të tyre seksual, por në bazë të praktikave(sjelljeve) seksuale (seksi oral dhe anal në mes meshkujve), të cilat e rrisin rrezikun e transmisionit dhe infeksionit me viruset e gjakut ose sëmundjeve seksualisht të transmetueshme. Të vetmet praktika seksuale në mes të meshkujve të cilat i përjashtojnë ata nga dhurimi i gjakut janë seksi oral apo anal. Sipas FDA-së<sup>5</sup>, meshkujt të cilët kanë pasur seks me meshkuj kanë prevalencë për HIV 60 herë më të madhe se popullata e përgjithshme, 800 herë më të madhe se dhuruesit e gjakut për herë të parë, dhe 8000 herë më të madhe se dhuruesit e rregullt të gjakut. Sipas FDA-së meshkujt të cilët kanë kontakt seksual me meshkuj (MSM), vazhdojnë të përfaqësojnë popullacionin me shkallën më të lartë të rrezikut të infeksionit me HIV. Poashtu Hepatiti B është 5-6 herë dhe Hepatiti C është 2 here më i shpeshte tek MSM-ja sesa tek popullata e përgjithshme. Pavarësisht kësaj, QKKTGJ-ja në asnjë mënyrë nuk mbështet homofobinë apo stereotipet e orientimeve seksuale.

Rezoluta e Këshillit Evropian CM/Res (2008)5<sup>6</sup> nxjerr në pah se e drejta e pacientit për të marrur gjakun më të sigurt të mundshëm është mbi konsideratat tjera, përfshirë edhe vullnetin individual për të dhuruar gjak. Andaj, duke zbatuar parimin *prima non nocere* (së pari mos bëj dëm), QKKTGJ-ja angazhohet që pacientët nga gjaku i marrur të kenë vetëm benefite shëndetësore e asesi dëm apo të përfitojnë sëmundje të rënda.

Shumica e vendeve të Bashkimit Evropian, Shtetet e Bashkuara e Kanada<sup>7</sup> refuzojnë në mënyrë permanente MSM-të për dhurim vullnetar të gjakut. Disa vende kanë relativizuar kohëzgjatjen e refuzimit nga 1-10 vite nga kontakti i fundit seksual i mashkullit me mashkull.

---

<sup>4</sup> Lista e kategorive të cilët refuzohen për dhurim është shumë më e gjerë.

<sup>5</sup> [www.fda.gov/biologicsbloodvaccines/bloodbloodproducts/questionsaboutblood/ucm108186.htm](http://www.fda.gov/biologicsbloodvaccines/bloodbloodproducts/questionsaboutblood/ucm108186.htm)

<sup>6</sup> Resolution on Donor Responsibility and Limitations of the Right to Donate Blood or its Components, March 2008

<sup>7</sup> [www.blood.ca/centreapps/internet/uw\\_v502\\_mainengine.nsf/page/Indefinite%20Deferral?OpenDocument](http://www.blood.ca/centreapps/internet/uw_v502_mainengine.nsf/page/Indefinite%20Deferral?OpenDocument)

QKKTGJ-ja konsideron se të gjitha kriteret dhe standardet e vendosura janë në pajtueshmëri me ligjet e dhe Kushtetutën e Kosovës, dhe se në asnjë mënyrë nuk cenojnë të drejtat elementare të individëve të caktuar. QKKTGJ çmon vullnetin fisnik të secilit qytetarë për të dhuruar gjak, mirëpo në të njëjtën kohë zbaton kriteret të cilat në njërin anë ruajnë shëndetin e dhuruesve, kurse rrisin maksimalisht sigurinë dhe cilësinë e produkteve të gjakut, e me këtë efikasitetin e këtyre produkteve jetë-shpëtuese..

“Dhurimi i gjakut është dhuratë. Dhurimi i gjakut bëhet sipas vullnetit të lirë, mirëpo e njëjta mund të pranohet ose refuzohet sipas vullnetit të lirë. Andaj nuk ka diskriminim, nëse dhurimi i gjakut refuzohet për arsye të ruajtjes së shëndetit publik”<sup>8</sup>

Secili nga ne mund të ketë nevojë për gjak në të ardhmen, andaj duhet maksimalisht të angazhohemi në rritjen maksimale të sigurisë së gjakut dhe produkteve të tija.

Me respekt,

QKKTGJ, Prishtinë

---

<sup>8</sup> Rasti CBS vs Freeman, Ontario, Kanada. Konkluzionet e gjyqtarit në arsyetimin e verdiktit pro CBS